

Gruas Kosovare

Përmbajtja

- 2 Fushata "Të Njohim të Drejtat"
- 2 Punëtori Regjionale në Implementimin e Resolutes 1325
- 2 OJQ-të e Grave nga Kosova dhe Pekin +10
- 3 Grupet Përkrahëse "Gratë për Gratë"
- 3 Urgent Action Fund viziton Kosovën
- 3 Shenimet nga Takimi i RRGK ne mentor
- 4 Fushata "Gratë Propozojne" feston
- 4 Anëtarja e Rrjetit Informon Avokim përmes Hulumtimit

Njohtimet

Publikimi i Përmbledhjes në studime Gjinore i QKSGj në Bibliotekën Kombëtare.....
.....**31 mars, 15:00**

Takimi i ardhshëm i RRGK në HCIC.....**4 prill, 11:00**

Publikimi i raportit "Zeri i Grave".....**7 prill**

RRJETI I GRUPEVE TË
GRAVE TË KOSOVËS



KOSOVA WOMENS
NETWORK

www.womensnetwork.org

90 anëtarë dhe partnerë të RRGK marrin pjesë në Takimin Vjetor të Anëtarëve

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RRGK) mbajti për herë të dytë Takimin Vjetor të Anëtarëve, më 4 dhjetor në Prishtinë. Në këtë mbledhje RRGK prezantoi raportin vjetor programor dhe financiar dhe Planin Strategjik për 2005 - 2008.

Anëtarët e RRGK, po ashtu, zgjodhën dy anëtarë të rinj të Bordit dhe rizgjodhën dy anëtarë të tjera. Anëtarët e Bordit të RRGK për 2005 janë: Delina Fico, Marta Prekpalaj, Luljeta Vuניqi, Naxhije Bućinca, Vjosa Dobruna, Belgjzare Muharremi dhe Behar Selimi.

Mbledhja përfundoi me një



Vjosa Dobruna, anëtare e Bordit të RRGK prezantoi informata lidhur me hapat e mëtejshme të zhvillimit të Fondit për Gratë e Kosovës në Takimin Vjetor të RRGK në Prishtinë.

shfaqjen nga fushata "Të Njohim të Drejtat!" të titulluar "Ato Gux-

ojnë të Flasin", e cila u ndoq nga anëtarët e RRGK dhe mysafirët.

RRGK bashkëpunon me rrjetet të tjera të grave

Rrjeti i Grave nga Maqedonia

RRGK në bashkëpunim me Rrjetin e Grave nga Maqedonia "Së Bashku" dhe Fondacionin Friedrich Nauman organizoi një punëtori dyditore të titulluar "Nga Menaxhimi i Konfliktëve drejt Komunikimit dhe Bashkëpunimit". Punëtorja u mbajt më 25 - 26 tetor në Grand Hotel, Prishtinë.

Përfaqësueset nga RRGK prezantuan punën e tyre në temat: Roli i Grave në Zhvillimin e Shoqërisë Civile; Kosova pas Zgjedhjeve dhe Kosova pas Zgjedhjeve e Sfidat për të Ardh-

men e Re- gjonit. Përfaqësueset nga Maqedonia prezantuan rrjetin e tyre "Së Bashku" dhe diskutuan lidhur me punën në Maqedoni pas konfliktit, si dhe sfidat me të cilat do të përballohet Maqedonia nëse mbahet referendumi. Gjatë seancës së grupeve punuese, pjesëmarrësit përgatitën një listë të çështjeve të përbashkëta dhe rekomandime për rrjetet përkatëse. Pjesëmarrëset, po ashtu, u takuan me Presidentin e Kuvendit të Kosovës, z. Nexhat Daci. Të dyja rrjetet kanë plane për bashkëpunim në të ardhmen dhe do ta vazhdojnë komunikimin.

Rrjeti i Grave nga Bosnja dhe Hercegovina

Një delegacion i 12 grave nga Bosnja dhe Hercegovina vizituan Kosovën në një punëtori treditore më 28 nëntor - 2 dhjetor. Gjatë vizitës ato u takuan me OJQ dhe grupe të grave nga mbarë Kosova. Më 29 nëntor RRGK organizoi një takim ndërmjet grave nga BH dhe OJQ serbe në Graçanicë. Më 30 nëntor ato u takuan me anëtarët dhe partnerët e RRGK në Prishtinë. Më 1 dhjetor gratë nga BH u takuan me Rrjetin e Grave në Prizren dhe vizituan Qendrën e Grave Rome.

Tema kryesore e diskutimeve mes grave nga BH dhe atyre nga Kosova ishte "Komunikimi dhe Investimi Emocional/ Kërkimi i një Baze të Përbashkët". Kjo vizitë studimore ishte një mundësi që gratë nga BH të shkëmbejnë përvoja me gratë kosovare për aktivitete që lidhen me ndërtim e paqes dhe çështjet e grave.

Kjo vizite u mbështet financiarisht nga Kvinna till Kvinna.



Përfaqësueset e RRGK dhe Rrjetit të Grave nga Maqedonia u takuan me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës në tetor.



OJQ-të e grave nga Kosova ndihmojnë në përgatitjet për Pekin +10

Tri përfaqësuese të RRGK morën pjesë në Forumin e OJQ-ve në Takimin Regjional Përgatitor për Analizën e Pekin +10, i cili u mbajt në Gjenevë më 12 dhe 13 dhjetor.

Temat kryesore në takimin për Analizën e Pekin+10 ishin: gratë në ekonomi, mekanizmat institucionalë për promovimin e barazisë gjinore, trafikimi i grave në kontekstin e lëvizjeve të migrimit dhe çështje të tjera të rëndësishme.

Sesioni i Komisionit të KB mbi Statusin e Grave me temën Pekin+10 do të mbahet në mars në New York. Gjatë sesionit dyjavor OJQ-të e grave nga e gjithë bota do të mbledhen në New York që të bëjnë presion mbi qeveritë e tyre që të ripohojnë Konventën për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW), konventë kjo me të cilën qeveritë u pajtuan dhjetë vjet më parë në konferencën e Pekinit. CEDAW specifikon masat që qeveritë duhet të ndërmarrin sa i përket grave dhe shëndetit, ekonomisë, sigurisë, etj.

CEDAW është adoptuar në 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e KB. Kjo konventë përbëhet nga parathënia dhe 30 artikuj. Ajo definoi se çka përbën diskriminimin kundër grave dhe paraqet një agjendë të veprimit për t'i dhënë fund këtij diskriminimi.

Pjesëmarrja e grave nga Kosova në takimin përgatitor në Gjenevë u përkrah financiarisht nga UNDP (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara).

Për më shumë informata, shkoni në:
www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/index.html

www.womensnetwork.org

“Të Njohim të Drejtat” shpjegon legjislacionin

Mekanizmat për barazi gjinore ekzistojnë, por sa dinë qytetarët për to?

Lëvizja e grave në Kosovë ka një histori të gjatë që fillon para luftës së fundit dhe prezencës ndërkombëtare në regjion. Gjatë viteve të fundit politikanët në Kosovë kanë përkrahur më shumë publikisht lëvizjen e grave dhe gjithnjë e më shumë po e njohin rëndësinë e legjislacionit për të drejtat nga perspektiva gjinore. Plani Kombëtar për Veprim, Ligji për Barazi Gjinore, Ligji kundër Diskriminimit dhe Ligji mbi Familjen janë arritje të mëdha në drejtim të realizimit të barazisë gjinore dhe lehtësojnë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Megjithatë, problemet sociale, siç janë dhuna kundër grave, trafikimi për prostitucion, shkalla e ulët e ndjekjes nga vajzat e arsimit të mesëm dhe universitar, shkalla e lartë e varfërisë së femrave, diskriminimi në baza gjinore në sektorin

privat, si dhe mungesa e përfaqësimit të grave në politikë, janë ende shqetësuese në Kosovë. Ndonëse ekzistojnë mekanizmat për barazi gjinore në nivel të politikës, shumë burra dhe gra vazhdojnë të mos jenë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre apo për mundësitë e qasjes në mbrojtjen e këtyre të drejtave të siguruar me ligjet e reja. Meqenëse shumë pak njerëz i njohin të drejtat e tyre apo mundësitë si t'i shfrytëzojnë shërbimet e Ombudspersonit, implementimi i ligjeve dhe realizimi plotësisht i potencialit të tyre për ndryshime shoqërore, në situatën e tanishme politike, mbetet i vështirë.

Fushata “Të Njohim të Drejtat” e RRGK synon t'i informojë qytetarët për të drejtat e tyre, si dhe për mekanizmat ekzistues për barazi gjinore. Në shfaqjen që e shoqëroi fillimin e kësaj fushate, pesë artiste të famshme: Safete Rogova, Shqipërije Bucaj, Teuta Sadiku, Edona Reshitaj dhe Nora Mehmeti treguan storie që përshkruajnë mekanizmat për barazi gjinore. Artistet përdorën kulturën e jetës së përditshme duke përfshirë dramë teatrale dhe këngët si mjete edukimi

nga dhuna familjare. Kjo pjesë e dramës dokumenton fillimisht shqetësimin e saj dhe ndjenjën e të qenit të pafuqishme si një grua e keqtrajtuar, mundësitë e arsimit të siguruar nga Ligji mbi Familjen dhe vizita e mundshme tek Ombudspersoni. Kjo storie përfundon me përmirësimin e gjendjes së gruas protagoniste.

Dialogët dramatizojnë përvojat e grave, duke përdorur bashkëbisedimin ndërmjet aktoreve. Ato shpjegojnë se si do të mund të përdorëshin mekanizmat për barazi gjinore. Këto storie bazohen mbi ngjarje konkrete nga jeta e grave.

Çdo pjesë e shfaqjes së fushatës përfshin një këngë, e cila paraqet të dhëna mbi ligjet apo promovon barazinë gjinore. Fushata përmban tre këngë.

“A kemi në të Drejtë?”

B. B. Poqi dhe Teuta Kurti pyesin në një baladë të mrekullueshme të kompozuar nga Nexhat Macula, teksti i shkruar nga Virtyt Kelmendi.

“Të nuk e di e Fortë sa Jam”

Alba Loxha këndoi këtë këngë ritmike të kompozuar nga Andin Randobrava, teksti i shkruar nga Aida Baraku.

“Vetëm Fol”

Është kënga e fundit e kësaj shfaqjeje që thërret gratë. Kënga është e kompozuar nga Armend Rexhepagiqi, teksti i shkruar nga Aida Baraku, kënduar nga Teuta Kurti, Alba Loxha dhe Edona Reshita.

Fushata filloi më 29 nëntor në Prishtinë, duke shënuar Ditën Ndërkombëtare kundër Dhunës kundër Grave. Shfaqja është përsëritur në Prizren më 2 dhjetor dhe në Mitrovicë më 3 dhjetor.

Sponsor medial i kësaj fushate ishte RTV 21. Fushata u përkrah financiarisht nga UNIFEM. Kjo fushatë do të vazhdojë në vitin 2005 me shfaqje në tërë Kosovën.



BB Poqi dhe Teuta Kurti duke kënduar “Sytë e Ikjes” në teatrin ODA në Prishtinë. Spoti i kësaj kënge po shfaqet në stacionet e ndryshme televizive në gjithë Kosovën.

Gratë nga Kosova marrin pjesë në Punëtorinë Regjionale për Implementimin e Rezolutës 1325 të KB

Si vijim i diskutimeve fillestare të mbajtura në shkurt në Prishtinë, në tetor 2004 në Sarajevë u mbajt Punëtoria Regjionale për Implementimin e Rezolutës 1325 të KB

Kjo punëtori u udhëhoq dhe u fi-

nancua nga UNIFEM dhe Kvinna Till Kvinna. Gratë nga Kosova, Serbia dhe Mali i Zi, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia diskutuan implementimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të KB.

Si rezultat i këtij takimi u përpilua një letër e përbashkët, e cila u dërgua Këshillit të Sigurimit të KB. Në letër shprehet përkrahjen e pjesëmarrësve në këtë punëtori për implementimin e Rezolutës 1325 të KB.

Projekti "Gratë përkrahin Gratë", i cili filloi në tetor 2004, ka tërhequr vëmendjen e 393 nënave të reja, si dhe të atyre që kanë ndërmend të bëhen nëna. Projekti iu ka ofruar trajnime, këshillime, vizita shtëpiake dhe këshillime me anë të telefonit të gjitha nënave anë e mbanë Kosovës. Këtu janë përfshirë nënat shtëpiake, nënat në punë, nënat në zonat urbane dhe rurale, si dhe nëna nga komunitetet rome, boshnjake, shqiptare dhe të tjera. Projekti ka qenë shumë i suksesshëm tek nënat e grupmoshës 20-25 vjeçare, si dhe tek gratë që kanë dëshirë të bëhen nëna.

Nënat kosovare përballen me pritje të mëdha nga familjet e tyre dhe nga komuniteti. Ato mbajnë më shumë përgjegjësi për zhvillimin emocional të fëmijëve të tyre se baballarët, motrat dhe vëllezërit. Shumica e këtyre nënave i ushqejnë fëmijët e tyre me gji.

Nënat përballen me këshilla nga të gjitha drejtimet si nga familja, por edhe nga produktet që ofron tregu, pediatri dhe personeli i maternitetit. "Nënat që Përkrahin Nënata" është një zë më shumë që kontribuon në këtë kontradiktë, sepse projekti është përballur me disa sfida që kanë të bëjnë me stereotipa kulturore ose ide të reja. Për shembull, shumica e nënave kanë filluar të përdorin formulat në bazë të promovimit që u bëhet

atyre në media. Këto nëna kanë më shumë nevojë për informata mbi të ushqyerin me gji, në mënyrë që të rritet interesi i tyre e të kuptojnë vlerën e vërtetë të të ushqyerit me gji.

"Grupet Përkrahëse për Nënata" shpeshojnë të ngrenë shkallën e vetëdijesimit të nënave për sa i përket të ushqyerit me gji, duke iu ofruar atyre më shumë informata. Për shembull, nënat që nuk i ushqejnë fëmijët e tyre me qumësht të gjirit, rrisin rrezikun e tyre për kancer të gjirit. Gratë që nuk ushqejnë me qumësht të gjirit ose i ushqejnë fëmijët e tyre për më pak se tre muaj, bëhen subjekt i një menopauze të hershme, një shembull ky që ka ndodhur në Ferizaj. Nëse gratë me fëmijë u japin qumësht fëmijëve të tyre për më shumë se 24 muaj ose dhe më gjatë, ato mund t'i reduktojnë këto rreziqe. Kjo është shumë e vërtetë, sidomos në ato nëna, të cilat japin gji në moshë të hershme.

Grupet Përkrahëse për Nënata



Koordinatorja lokale e Pejës, Ardita Bala, promovon projektin e Grupeve Përkrahëse për Nënata në radion lokale Dukagjini.

kanë dhënë informata dhe mbështetje, si dhe i kanë inkurajuar nënat për të ushqyer fëmijët e tyre me gji. Me anë të këtij projekti, anëtarët e Grupeve Përkrahëse dhe koordinatorët lokalë kanë ofruar gjithashtu mendimet, idetë dhe sugjerimet e tyre se si të zgjerohet ky projekt dhe se si të punohet më tej për të rritur shkallën e vetëdijesimit për të ushqyerit me gji në të gjithë Kosovën. RRGKK shpreson të ofrojë informata dhe këshilla për së paku 4000 nëna deri në fund të këtij projekti.

Ky projekt mbështetet financiarisht nga UNICEF.

RRGGK takohet me Fondin për Ndërhyrje të Shpejtë për të Drejtat e Grave (Urgent Action Fund - UAF)

Përfaqësueset e Fondit për Ndërhyrje të Shpejtë për të Drejtat e Grave (UAF), Drejtorja Ekzekutive, Julie Shaw, dhe konsulentja Jane Barry, të shoqëruar nga aktivistja e njohur për të drejtat e grave Marta Drury, u takuan me përfaqësues dhe partnerë të RRGKK-së më 16 dhjetor në Prishtinë.

UAF është një organizatë ndërkombëtare që fokusohet tek të drejtat e grave. Organizata bashkëpunon me aktivistet femra për të ndërtuar paqen në tre situata kryesore: konflikti i armatosur, përshkallëzimin e dhunës, si dhe vendet me paqëndrueshmëri politike. UAF ka mbështetur organizata të grave dhe aktiviste në Kosovë dhe në Evropën Juglindore që nga mesi i viteve 1990 e vazhdon t'i mbështesë edhe sot.



Drejtorja Ekzekutive e UAF Julie Shaw (në të majtë) dhe këshilla për kosovarët që të nisin përgjigjet e tyre të shpejta përmes programeve .Marta Drury (në të djathtë) dhe Jane Barry (akoma dhe më në të djathtë) dëgjonin.

UAF është shumë entuziaste për të mbështetur aktivistet lokale në krijimin dhe menaxhimin e granteve, të cilat mund të japin mbështetje financiare për ndërhyrje të menjëhershme strategjike nga ana e aktivisteve të të drejtave të grave.

Në këtë takim me RRGKK për-

faqësueset e UAF prezantuan raportin "Të Kundërpërgjigjemi: Aktivizimi i të Drejtave të Grave në Konflikt". Ato, po ashtu, kontribuan në diskutimet mbi krijimin e Fondit të Grave duke dhënë njohuritë dhe eksperiencat e tyre.

Takimi i rregullt i RRGKK në nëntor

Në takimin dymujor të RRGKK në 1 nëntor u diskutuan pikat e mëposhtme:

- Fushata "Dil dhe Voto". Lumnije Deçani nga Qendra për Mirëqenien e Gruas në Pejë dha një përshkrim të përgjithshëm se çfarë po bëhet në komunën e Pejës për këtë fushatë.

- Fushata "Gratë Propozojnë". Violeta Selimi, koordinatore e fushatës, dha informata për këtë fushatë. Ju lutemi, shikoni faqen 4 për më shumë informacion.

- Fushata "Grupet Përkrahëse të Nënave që Ushqejnë me Qumësht të Gjirit". Koordinatorja e fushatës Laura Ruhi bëri një prezantim të shkurtër të aktiviteteve të projektit. Pjesëmarrësit vunë në pyetje nëse statistikat që thonë se 12% e nënave kosovare i ushqejnë fëmijët e tyre me gji është e vlefshme ose jo. Një përfaqësues i UNICEF-it gjithashtu foli për projektin dhe adresoi disa nga çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit në takim.

- Punëtori e përbashkët me Rrjetin e Grupeve të Grave të Maqedonisë. Marte Prekalaj nga shoqata "Motrat Qiriazit" i informoi pjesëmarrësit lidhur me këtë punëtori. Ju lutemi, shikoni faqen 1 për më shumë informacion.

- Punëtorja në Sarajevë mbi Rezolutën 1325 të KB. Igballa Rogova nga RRGKK prezantoi rezultatet kryesore të kësaj punëtorie. Ju lutem, lexoni më shumë për të në faqen 2.

- Takimi Vjetor i RRGKK. Delina Fico, anëtare e bordit të RRGKK, shpjegoi procedurat për këtë takim dhe për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Bordit të RRGKK. Ajo ju kërkoi anëtarëve të RRGKK-së të dërgonin tri kandidatura për anëtarët e Bordit. Pjesëmarrësit zgjedhën 4 dhjetorin si datë për Takimin Vjetor të RRGKK.

- Anëtarët e RRGKK dhanë informacion për aktivitetet e tyre individuale. Ju lutemi, kontaktoni RRGKK për më shumë informacion.

Rrjeti i Grupeve t^o Grave t^o Kosov^os

www.womensnetwork.org

rrggk_kwn@yahoo.com

+381 (0)38 245 850

Agim Ramadani Nr. 50/8

Prishtinë, Kosovë

Stafi i RRGK

Igballe Rogova

Drejtoresha Ekzekutive
igorogova@yahoo.com

Elita Gota

Menaxherja e Programit
elitagota@yahoo.com

Besa Shehu

Menaxherja e Financave
besa_shehu@yahoo.com

Violeta Selimi

Koordinatorja e Fushatës
"Gratë Propozojnë"
vselimi@atoda.org

Laura Ruhi

Koordinatorja e Fushatës
"Gratë për Gratë"
lauraruhi@yahoo.com

Bordi i RRGK

Naxhije Buçinca

Delina Fico

Lule Vuniqi

Marta Prekpalaj

Vjosa Dobruna

Belgijzare Muharremi

Behar Selimi

Falënderim i Veçante

Viti 2004 ka qenë mjaft i suksesshëm për RRGK duke iu falënderuar energjisë të shkëlqyer, përkrahjes morale dhe financiare të siguruar nga partneret e saj: Rrjeti STAR i World Learning; Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS); Agjencioni Kanadez për Zhvillim Ndërkombëtar (CIDA)/ Programi për Iniciativa Lokale të Kosovës (KLIP); Agjencioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA); Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE); Zyra Zvicereane për Bashkëpunim - Kosovë; UNIFEM; UNICEF; Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI); Kvinna Till Kvinna; Fondacioni Heart and Hand; UNDP dhe RTV21.

"Zëri i Gruas Kosovare"
është shkruar dhe dizajnuar
nga Elita Gota;
dhe redaktuar Nicole Farnsworth.

www.womensnetwork.org

RRGGK-ja përfundon fushatën "Gratë Propozojnë"

Gjatë fushatës "Gratë propozojnë" Zyrtarët komunalë për Çështjet Gjinore mbështetën koordinatorët lokalë të fushatës në organizimin e takimeve me kandidatet gra. Duke ditur që Zyrtarët Gjinore mund të përkrahin përfaqësueset gra në Kuvendin e Kosovës, RRGK organizoi një takim për të diskutuar punën



Znj. Naxhije Buçinca shprehu mirënjohjen e RRGK për koordinatorët më të suksesshëm lokal

e kryer gjatë fazës së parë dhe të dytë të fushatës, si dhe mënyrat e mundshme të bashkëpunimit me gratë politikane për të ardhmen. Takimi u mbajt në datën 22 dhjetor në Hotel Iliria në Prishtinë.

Pjesëmarrëset në këtë takim dhanë përshtypje pozitive për fushatën. Ato thanë se të dyja fazat e fushatës ishin të organizuara dhe planifikuara shumë mirë. Faza e parë kishte rritur interesin e grave për probleme që ato i hasin në komunat e tyre. Faza e dytë bëri të mundur që votuesit meshkuj dhe femra të takoheshin me kandidatet femra dhe të diskutonin rreth rolit që mund të luajnë anëtarët femra të Kuvendit të Kosovës. Në këtë takim gratë parlamentare, RRGK dhe Zyrtarët komunalë për Çështje Gjinore diskutuan për të zhvillimin e një plani të

përbashkët veprimi, si dhe për mënyrat e ndërveprimit mes tyre.

Në fund të këtij takimi, RRGK shprehu mirënjohjen ndaj koordinatoreve të fushatës për punën e kryer me sukses, si dhe ndaj gazetarëve dhe kameramanëve të RTV 21, të cilët kanë bërë një punë shembullore për mbulimin medial të të dyja fazave të fushatës.

Që kur filloi në 2003, fushata ka treguar se gratë janë shumë entuziaste për të marrë pjesë në jetën politike kosovare. Ato kanë vetëm nevojën për mbështetje dhe hapësirë, të cilat u përpoq t'i ofrojë edhe kjo fushatë.

Kjo fushatë u mbështet financiarisht nga Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Zyra Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim, me asistencë teknike të Rrjeti STAR të World Learning dhe UNIFEM.

Anëtarja e Rrjetit Informon Avokim përmes Hulumtimit

Qendra Kosovare për Studime Gjinore në Prishtinë është në fazën përfundimtare të hulumtimit të cilin anëtarët dhe partneret e RRGK mund ta kenë të dobishëm gjatë planifikimit të aktiviteteve të tyre, gjatë informimit të përpjekjeve avokuese dhe në rritjen e vetëdijesimit.

Së pari, *Si Votojnë Gratë?* Do të publikohet në prill. E njëjta analizon sistemin e votimit të grave, preferencat mbi liderët e partive politike dhe nivelin e vetëdijesimit mbi politikë; si është ndikuar në sjelljen e tyre gjatë votimit; dhe çfarë duan gratë nga politika. Shënimet ndahen në bazë të moshës, zonës gjeografike, edukimit, punësimit dhe gjendjes martesore.

"Ne presim të bashkëpunojmë me rrjetin" tha Luljeta Vuniqi, Drejtore e qendrës. "Rezultatet mund të shfrytëzohen për fushatën Gratë Propozojnë - për ti mobilizuar gratë që të votojnë në zgjedhjet lokale të ardhshme dhe se si ti përkrahin gratë në politike."

Së dyti, *Gratë Kosovare në Shoqëri Civile, 1980 - 2004* do të dokumentojë se si grupet e grave të shoqërisë civile kanë shkaktuar ndërrime politike, ekonomike dhe shoqërore në Kosovë. Ky hulum-

tim do ti analizojë përvojat, sfidat, arritjet dhe metodat e grave. Si pikë e tretë, projekti për rolin e gruas në politike do të fillojë në mars. Botimi i fundit i librave të publikuara do të shfrytëzohet për arsimimin e kosovareve të reja, studenteve të universitetit dhe komunitetin ndërkombëtar, lidhur me rolin që gratë e luajtën në Kosovë gjatë 25 viteve të fundit.

Përveç këtij hulumtimi, qendra punon me studentët mbi ndërgjegjësimin për sa i përket politikave që kanë të bëjnë me çështjen e ngacmimit seksual në Universitetin e Prishtinës. Qendra po ashtu ka publikuar Direktoriumin e OJQ-ve të Grave në Kosovë; përmbledhjen Interdisciplinare në Studime Gjinore me artikuj nga teoria feministe dhe studime; dhe një bibliografi me shënime të krejt literaturës që fokusohet në çështjet e grave gjatë viteve 1999 - 2004.

Qendra disponon me një bibliotekë dhe qendër të burimeve që është e hapur për anëtarët e RRGK, pa pagesë. Në bibliotekë gjenden tekste në gjuhën shqipe, serbishte, dhe anglisht, me tema të ndryshme: legjislativi ekzistues për çështje gjinore, hulumtime lidhur me çështjet gjinore në Kosovë,

statistika të tjera të Kosovës, teori të feministe, kontakt informativ dhe OJQ-ve, e shumë të tjera.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore rihapi dyert e veta në dhjetor 2004 me vizion të ri "sigurimi i përfshirjes së perspektivës gjinore në të gjitha sektorët e shoqërisë kosovare, duke ngritur vetëdijesimin për çështje gjinore, duke rritur përqendrimin e çështjeve gjinore në sistemin edukativ në Kosovë, duke zhvilluar studime gjinore dhe siguruar përfshirjen e politikave të ndjeshme në çështje gjinore në të gjithë sektorët e jetës."

Të gjitha keto aktivitete të qendrës janë të përkrahura nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Rrjeti i Institutit për Shoqëri të Hapur Programi i Grave dhe Kvinna Till Kvinna.



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Center for Gender Studies

Kontakt Informata

Bulevardi i Dëshmorëve, 63/3

Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 540 719

qksgj_kgsc@yahoo.com

Si mund të
na zëri
gjumi?

Fjala e Shqipe Malushit, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës Shqiptaro-Amerikane të Grave "Motrat Qiriazit", adresuar Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara gjatë takimit me OJQ-të me temë "Gratë, Siguria dhe Paqja", më 21 tetor 2004 në New York.

Ju lutem gjeni të bashkangjitur fjalimin e saj në këtë numër të Zërit të Gruas Kosovare.